



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/18  
Datë: 28.03.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafit 1.11 të nenit 12 dhe nenit 89 të Ligjit Nr. 04/I-125 për Shëndetësi, në zbatim të nenit 41 dhe 44 të Ligjit nr. 02/I-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Në kuadër të mbrojtjes së shëndetit publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë disa vendime, pas rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë, si:
  - Vendimi Nr. 01/07 i datës 11.03.2020 (i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 01/16 të datës 26.03.2020)
  - Vendimi Nr. 01/09 i datës 13.03.2020
  - Vendimi Nr. 01/10 i datës 14.03.2020
  - Vendimi Nr. 01/11 i datës 15.03.2020
  - Vendimi Nr. 01/15 i datës 23.03.2020 (i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 02/17 të datës 27 mars 2020)
2. Vendimet nga pika 1. e këtij vendimi mbeten në fuqi deri më 6 prill 2020.
3. Ministri i Shëndetësisë, jo më vonë se 3 prill 2020, vendimet e mësipërme i rishqyrton, në konsultim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, ekspertë dhe ministritë tjera të linjës, për të vlerësuar efikasitetin dhe domosdoshmërinë e masave të përcaktuara, si dhe i jep rekomandim Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me vazhdimin ose jo të vendimeve përkatëse.
4. Përveç pikës dy dhe tre të këtij vendimi, situatën epidemiologjike, Ministri i Shëndetësisë do ta ri-analizojë çdo ditë dhe në lidhje me secilin Vendim të lartcekur dhe, pas konsultave paraprake, mund t'i rekomandojë Qeverisë:
  - mbetjen në fuqi të Vendimit;
  - ndryshimin apo plotësimin e masave të përcaktuara me Vendim ose
  - shfuqizimin e Vendimit.
5. Obligohen Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë